

Bardhyl DEMIRAJ, München

NJË VATËR ALBANOLOGJIKE NË PËRVJETORIN E SAJ

Punimet e Seminarit të sivjetshëm përkojnë në kohë me dy përvjetorë të vatrës sonë albanologjike në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut. Vera e këtij viti qarkon plot 40 vjet, që kjo vatër ofron mësim të rregullt të gjuhës shqipe në Bavari. Qysh prej vitit 1961 ajo gjëllon si dega e vetme universitare në veri të Alpeve të Evropës, ku përgatiten dhe diplomohen albanologë të rinj. Hulumtimet e mirëfillta shkencore që zhvillohen në këtë qendër qysh prej themelimit të saj, vijojnë dhe plotësojnë më tej traditën disashekullore të studimeve albanologjike në Gjermani.

Gjithsesi pakkush është i mirëinformuar rreth formëzimit dhe konsolidimit të kësaj vatre si institucion shkencor-universitar, andaj po lejohem të ndalem përbledhtas në historikun e saj, ashtu siç na paraqitet në programin mësimor-shkencor të universitetit në këta 40 vjetët e fundit.¹ Një shfletim sado i shpejtë i këtij programi të krijon njëherësh bindjen se si krijimi ashtu edhe vazhdimësia e degës së albanologjisë në këtë universitet nuk janë thjesht rastësi por kryesisht frysht i punës ngulmuese të një studiuesi dhe shkrimitari shqiptar, që i përkushtoi asaj 30 vjetët më të fryshtshëm të veprimtarisë së tij shkencore-universitare.

Ishte albanologu i ri Martin Camaj që menjeherë pas promovimit të tij në Romë vjen në verën e vitit 1961 në Universitetin e Mynihut me një bursë dyvjeçare në kuadrin e shkëmbimeve akademike (DAAD). Edhe pse rekomandimin e bursës e kishte marrë nga sllavisti i mirënjohur Alois Schmaus, Camaj përzgjedh si vend studimi Seminarin e Gjuhësisë (*Sprachwissenschaftliches Seminar*), i cili atë kohë mbulonte degët universitare gjuhësi e krahasuar indoevropiane, gjuhësi e përgjithshme dhe hetitologji.

¹ Informacioni mbi programin universitar të kësaj dege është përditësuar me të dhënat e studimit të Hanne Adrom *Indogermanistik in München (1826 - 2001). Geschichte eines Faches und eines Instituts*. München 2001. Autores së këtij studimi dëshiroj t'i shpreh falenderimet e rastit edhe për ndihmën e pakursyer gjatë verifikimit të një numri të dhënash për degën e albanologjisë me regjistrimet e bëra në arkivin e Universitetit të Mynihut përgjatë katër dekadave të fundit.

Synimi i Camajt ishte fillimisht tejet modest. Ai vinte të përvetësonë metodat e studimit historik-krahasues ie., të cilat do t'i shërbenin më pas si mjet ndihmës në studimet e tij filologjike e diakronike në fushë të shqipes. Angazhimi i tij i menjëhershëm dhe i vazhdueshëm në programin universitar të seminarit - fillimisht me një kurs hyrës në gjuhën shqipe (WS 1961/2 - SS 1962) dhe më pas me mësimdhënien e gjuhës shqipe (prej WS 1962/3) - dëshmon jo vetëm aftësitë e Camajt si specialist i mirë i shqipes por edhe interesimin gjithnjë në rritje të seminarit për të plotësuar një boshllék në programin e vet universitar, pikërisht përvetësimin dhe hulumtimin e shqipes si njëra ndër gjuhët ie. më pak të studiuara.

Menjëherë pas përfundimit të bursës, drejtuesi i seminarit, prof. Wilhelm Wissmann, i ofron Camajt disa kontrata semestrale si lektor i shqipes, duke i mundësuar gjithashtu përfundimin e gradës së habilitacionit, të cilën e mbron me sukses në vitin 1965 me studimin *Fjalëformimi shqip*.²

Vitet 1965 deri 1971 do të jenë vendimtare si në karrierën akademike të Camajt ashtu edhe në fatin e ardhshëm të vatrës albanologjike të krijuar po prej tij. Doktori i habilituar ka fituar tashmë të drejtën për dhënie leksionesh e seminaresh në fushë të gjuhësisë krahasuese-indoevropiane. Por Camaj i mbetet gjithsesi besnik albanologjisë. Në leksionet e tij shqipja trajtohet jo vetëm si degë e veçantë e familjes indoevropiane,³ por edhe - ose kryesisht - si gjuhë e lashtë ballkanike, në zhvillimin shkallëshkallshëm të së cilës kanë ndikuar dukshëm marrëdhëniet e ndërsjella me gjuhët fqinjë.⁴ Në leksionet dhe seminaret mbi strukturën fonologjike dhe morfolologjike të shqipes së sotme dhe të dialekteve të saj⁵ Camaj zbaton me sukses metodat moderne të gjuhësisë së përgjithshme dhe të asaj areale. Gjithsesi ambicjet e tij profesionale as nuk fillojnë e as nuk mbarojnë këtu. Në programin universitar të këtyre viteve ndeshim edhe lëndë nga fusha të tillë, si etnografi, letërsi dhe filologji shqipe,⁶ të cilat zgjerojnë dukshëm spektrin e veprimitarës akademike të Camajt, duke profilizuar de faktò edhe fushën e albanologjisë si degë e veçantë studimesh universitare. Megjithëse ligjëron si docent në degën e indoeuropianistikës, leksionet e tij i ndjekin tashmë me interes krahas studentëve indoeuropianistë edhe sllavistë e romanistë, balkano-

² *Albanische Wortbildung* - dorëzuar më 1964 dhe botuar më pas në serinë "Albanische Forschungen" bl. 6, Wiesbaden 1966.

³ Fonetika historike e shqipes, WS 1965/66; Teoritë mbi prejardhjen e gjuhës shqipe, SS 1971.

⁴ Pika takimi gjuhësor shqiptaro-rumun, SS 1966; Latinishtja ballkanike dhe shqipja, WS 1966/67; Elementet sllave në shqipe, SS 1969; Elementet greke në shqipe, WS 1969/70; Fjalëformimi i shqipes duke mbajtur parasysh gjuhët e tjera ballkanike, WS 1970/71.

⁵ Morfologjia shqipe, SS 1966; Dialektologia shqipe, WS 1968/69, Kërkime dialektologjike shqiptare, SS 1970.

⁶ Etnografia shqiptare, WS 1967/8; SS 1968; Letërsia shqipe e shek. të 18-të, SS 1967.

logë e filologë të rinj, studentë e doktorantë të gjuhësisë së përgjithshme, të historisë së Evropës Juglindore etj.

Në kapërcyell të viteve akademikë 1970-1971 aktiviteti ndërdisiplinor i Seminarit të Gjuhësisë hyn në një fazë të re. Dega e hetitologjisë i bashkohet Seminarit të Asirologjisë. Vinden e saj e zë de jure dega gjermane "e pazakontë" e albanologjisë me profesor titullar Martin Camajn, i cili do ta drejtojë atë me sukses për 20 vjet me radhë. Synim kryesor i Camajt është tashmë konsolidimi i degës si qendër e re studimesh shkencore-universitare. Ndërsa programi mësimor i shqipes kishte përvijuar prej kohësh fizionominë e tij, paleta e programit universitar bëhet gjithnjë e më e larmishme. Në programet semestrale ndërķembajnjë rregullisht vendet fushat e ndryshme të gjuhësisë diakronike e sinkronike⁷ me ato të letërsisë shqipe⁸ dhe të folklorit shqiptar.⁹ Leximin kritik të shkrimeve të vjetra shqipe,¹⁰ shqyrtimin e aspekteve të ndryshme të normës gjuhësore letrare,¹¹ e sidomos hulumtimin e shqipes së diasporës arbëreshe në Greqi dhe Itali¹² e ndeshim në programin e thuajse çdo semestri. Interes të veçantë paraqet organizimi i seminareve dhe i kolokuiumeve të përbashkëta me specialistë si edhe doktorandë të fushave të ndryshme, të cilët do të debutojnë më pas me sukses edhe në albanologji.¹³

⁷ Çështje të gramatikës shqipe, WS 1973/74; Çështje themelore të sintaksës së shqipes, SS 1975, WS 1980/81; Morfolloji & gjuhës shqipe, SS 1976; Çështje të kontaktit gjuhësor (llavishtaja jugore -shqipja), WS 1979/80; Sintaksa shqipe, SS 1984; Gramatikat më të vjetra shqipe, WS 1984/5; Shqipja si gjuhë indoevropiane, SS 1985; Gjuha e mjeteve të komunikimit modern, SS 1985; Çështje të përkthimit teknik prej shqipes, WS 1986/87; Aspekte socialshkencore në Shqipëri sot, WS 1988/89.

⁸ Letërsia moderne shqiptare, WS 1974/75; Çështje të letërsisë shqiptare në Kalabri, SS 1980; Tiparet themelore të letërsisë bashkëkohore shqipe, SS 1982; Lektyrë e lirikës moderne shqiptare, WS 1984/5; Hyrje në historinë e letërsisë shqipe, SS 1987, SS 1988; Eposi "Lahuta e malcis" e Gjergj Fishtës (Gjuha dhe metrika), SS 1988; Letërsia moderne italo-arbëreshe, SS 1989.

⁹ Sintaksa e përrallave populllore shqiptare, SS 1987; Përbajtja dhe struktura e këngëve të kreshnikëve në Shqipërinë e Veriut, WS 1988/89.

¹⁰ Gjuha e teksteve të vjetra, WS 1971/2; Tekste të shekullit të 16-të, SS 1976, SS 1977; Lektyrë e teksteve shqipe të shek. të 17-të, WS 1982/3, WS 1983/4; Lektyrë e teksteve shqipe të shek. të 16-të, SS 1983; Gjuha e këngëve të kreshnikëve, WS 1983/4; Gjuha e teksteve liturgjike (arbëreshe), SS 1984; Lektyrë e teksteve shqipe, WS 1986/87; Lektyrë e teksteve liturgjike të shek. të 17.-të, WS 1987/88; Gjuha e teksteve liturgjike të shek. e 16-të, WS 1988/89; Gjuha dhe stili i "Cuneus Prophetarum" (1685) të Pjetër Bogdanit, WS 1989/90; Analizë teksti e "Dottrina Christiana" (1618) të Budit, SS 1990.

¹¹ Çështje të gjuhës letrare shqipe, SS 1972 - WS 1972/3; Çështje të normimit të gjuhës së shkruar shqipe WS 1982/3;

¹² Klasifikimi i të folmeve arbëreshe të Italisë së Jugut, SS 1973; Kontakte gjuhësore midis shqipes së Veriut dhe të folmeve montenegrinase jugore, WS 1976/77, SS 1978; Çështje të dialektologjisë shqiptare, SS 1977; Kontakte gjuhësore italo-arbëreshe në Kalabri, WS 1978; Hyrje në të folmet arbëreshe të Greqisë, SS 1981; Struktura e së folmes së S. Constantino Albanese, SS 1981; Çështje të kontaktit gjuhësor tek Arbëreshët e Italisë së Jugut, SS 1983.

¹³ Camaj, M./ Sasse, H.J./ Bevington, G.L.: Hyrje në fonologjinë gjenerative të shqipes, WS 1976; Camaj, M./ Sasse, H.J.: Meshari i Gjon Buzukut, WS 1981/82; Hyrje në të folmet arbëreshe të Greqisë, SS 1981;

Vihet re një interesim gjithnjë në rritje i albanologëve nga vende të ndryshme, të cilët duan të thellojnë njohuritë e tyre, të spezializohen ose të punojnë pranë kësaj qendre (F. Altimari, G. Bevington, Z. Mirdita, A. Berisha, L. Mulaku etj.). Një nxitje të veçantë fiton bashkëpunimi me qendrën albanologjike të Prishtinës, sidomos pas vitit 1974, kur themelohet Seminari Ndërkombetar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Kosova u mundëson tashmë studentëve dhe studiuesve bavarezë thellimin e njohurive të tyre në gjuhën shqipe dhe në fushën e albanologjisë në përgjithësi. Pra nuk mund të quhet rastësi, që edhe në Seminarin e sivjetshëm marrin pjesë nga Bavaria të paktën 12 studentë të albanologjisë dhe të interesuar për gjuhën shqipe.

Në verën e vitit 1990 bursanti i dikurshëm shqiptar përfundon karrierën e tij akademike si profesor i emerituar në një universitet perëndimor, duke lënë pas një traditë të mirë universitare në lëmin e albanologjisë.

Pas një ndërprerje prej një semestri (WS 1990/91) dega e albanologjisë në rifillon aktivitetin e saj në Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe të Përgjithshme (*Institut für Vergleichende und Allgemeine Sprachwissenschaft*) me një profesor titullar të ri, albanologun dhe balkanologun gjerman Wilfried Fiedler, i cili do ta drejtojë atë deri në verën e vitit 1998. Programi universitar, i zhvilluar në këtë periudhë mund të konsiderohet me të drejtë si rikonfirmim i një tradite tashmë të krijuar: studimi shkencor-universitar i fushave të gjuhësisë diakronike¹⁴ e sinkronike,¹⁵ të dialektologjisë¹⁶ dhe të filologjisë shqipe,¹⁷ të folklorit dhe të kulturës popullore.¹⁸ Në realizimin e programit universitar angazhohen në vazhdimësi doktorandë e bashkëpunëtorë të rinj,¹⁹ të cilët përgatiten në karrierën

Camaj, M./ B. Bartl: Histori e hulumtimeve albanologjike, WS 1986/87; Camaj, M./ Bartl, P./ Lange: Aspekte soziale-shkencore bashkëkohore në Shqipëri, WS 1987/88; Camaj, M./ Bartl, P.: Shqiptarët në diasporë, WS 1988/89; Kolokvium promociioni, WS 1977/78, SS 1979, SS 1980, SS 1981, WS 1981/82.

¹⁴ Histori e gjuhës shqipe, SS 1991, WS 1991/2, WS 1996/97, SS 1997; Morfologji historike e shqipes: Sistemi foljor i shqipes (në aspektin indoevropianistik dhe balkanologjik), SS 1991; Gramatikë historike e shqipes, WS 1992/3, SS 1993; Shqipja në rrethin e gjuhëve indoevro-piane, SS 1994.

¹⁵ Gjuha shqipe në kohën tonë, SS 1992, WS 1995/96, WS 1997/98; Gramatika e foljes shqipe WS 1993/94, SS 1994; Sistemi foljor i shqipes dhe i gjuhëve të tjera ballkanike, WS 1994/95; Sistemi foljor i shqipes, SS 1996; Tipologji e gjuhës shqipe dhe e dialekteve të saj, WS 1996/97; Sintaksë shqipe, SS 1998.

¹⁶ Hyrje në shqipen e Gregisë WS 1993/94; Dialektologji shqipe, WS 1997/98.

¹⁷ Përkthime shqipe të biblës në shek. e 19-të, WS 1991/92; Gegërishtja veriore (Gjon Buzuku), WS 1994/95, WS 1995/96; SS 1996; Lektyrë kursore e teksteve të vjetra shqipe (Gjon Buzuku), SS 1997; Lektyrë tekstesh të vështira të gegërishtes veriore, SS 1998.

¹⁸ Hyrje në folklorin shqiptar, SS 1992, WS 1992/93; Hyrje në letërsinë popullore shqipe, SS 1993; Doke dhe zakone të shqiptarëve në përqasje ballkanike, SS 1998.

¹⁹ Hock, W.: Fonetikë historike e shqipes, SS 1995; Klosi, A.: Lektyrë kursore tekstesh shqip, WS 1993/94; Konversacion shqip, SS 1994, WS 1994/95, WS 1996/97; Letërsia shqipe pas vitit 1945, SS 1995; Normimi i gjuhës shqipe dhe gegërishtja, SS 1995; Zhvillimi i gjuhës shqipe prej vitit 1970, SS 1997; Zhvillime më të reja të gjuhës së sotme shqipe, WS 1997/98; Reforma gjuhësore dhe shqipja jashtë kufijve, SS 1998; Bajri, H.: Konversacion shqip(tutorium), SS 1998.

e tyre shkencore-universitare. Meritë e veçantë e Fiedler-it është kanonizimi i programit universitar të degës; duke ia përshtatur atë interesave të studentëve që studionin albanologjinë si degë kryesore ose të dytë. Përvetësimi i shqipes standarte, marrëdhëniet e saj me dialektet si edhe përfundimi me sukses i kurseve hyrës në albanologji,²⁰ në indoevropianistikë ose në gjuhësinë e përgjithshme realizohen tashmë në një qark kohor prej katër semestrash. Studentëve u krijohet më pas mundësia të marrin specializim të veçantë në fusha të ndryshme të albanologjisë, si p.sh. në gramatikën dhe fonetikën historike dhe bashkëkohore të shqipes, në dialektologji dhe filologji, në letërsinë dhe kulturën popullore etj.

Shkëputja i Fiedler-it nga karriera akademike (SS 1998) përkon në kohë me një periudhë të vështirë reformash tranzitore (1999 -2000), që prekën një numër të madh degësh "të vogla" universitare në universitetet gjermane. Rreziku i mbylljes së degës së albanologjisë në Universitetin e Mynihut përballohet në saje të angazhimit të madh të (ish-)studentëve dhe albanologëve gjermanë e të huaj si edhe të institucioneve shkencore e shtetërore shqiptare. Rol vendimtar në këtë rrjedhë ngjarjesh luajnë edhe intelektualët kosovarë, ndër radhët e të cilëve gjendet përfaqësuesi më i përshtatshëm për të siguruar vazhdimësinë e degës. Albanologu i mirënjojur Rexhep Ismajli vjen në Mynih dhe përfaqëson profesurën e albanologjisë për dy vjet me radhë (WS 1998/99 - SS 2000), duke zhvilluar me ngarkesë të plotë²¹ programin universitar, madje duke e rifreskuar atë më tej me pjesëmarrjen e studiuesve dhe tutorëve të rinj.²²

Largimi i Ismajlit për në vendlindje pasohet me drejtimin e programit universitar të degës së albanologjisë prej Bardhyl Demirajt,²³ i cili më 1 mars të vitit 2001 emërohet profesor titullar i saj.

Pas përfundimit të reformave administrative të universitetit dega e albanologjisë vijon aktivitetin e saj,²⁴ e bashkëlidhur me trungun e saj buri-

²⁰ Hyrje në albanologji, SS 1992, WS 1994/5, WS 1995/96, WS 1996/97, WS 1997/98.

²¹ Histori e gjuhës shqipe, WS 1998/99, SS 1999, WS 1999/2000, SS 2000; Tekste shqipe dhe kapituj të zgjedhur nga letërsia shqipe, WS 1998/99, SS 1999; Dialektologji shqipe, SS 1999; Komentar mbi librin e së drejtës zakonore "Kanuni i L. Dukagjinit", WS 1999/2000; Morfologji e shqipes standarde, WS 1999/2000; Tekste të vjetra shqipe, WS 1999/2000; Shqipja dhe gjuhë të tjera ballkanike, SS 2000; Leksiku i shqipes, SS 2000; Letërsi shqipe, SS 2000.

²² Cyllock, A.: Hyrje në albanologji (Tutorium), WS 1998/99; Bazat e gramatikës shqipe (Tutorium), WS 1999/2000; Xhyra, J.: Letërsi shqipe, WS 1999/2000; Demiraj, B.: Etimologji shqipe, SS 2000.

²³ Leksione, seminare, ushtrime në WS 2000/01: B. Demiraj: Letërsia klerikale dhe artistike shqiptare në periudhën e Rilindjes Kombëtare; Shqipja në qerthullin e gjuhësise ballkanike; Tekste të vjetra shqipe të shek. të 17-të (Franciscus Blancus); Polisemia dhe fjalëformimi i shqipes standarde; Gegërishtja veriperëndimore; J. Xhyra: Shqip III/1; A. Cyllock: Hyrje në Albanologji; Histori e gramatikave të gjuhës shqipe (tutorium);

mor, pikërisht me degën e gjuhësisë së krahasuar-indoevropiane, që drejtohet tashmë prej profesorit titullar Peter Schrijver. Më 1 prill 2001 Instituti pagëzohet me një emër të ri: *Instituti i Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoevropiane si edhe i Albanologjisë* (*Institut für Vergleichende und Indo-germanische Sprachwissenschaft sowie Albanologie*). Vatra albanologjike në Bavari vazhdon veprimtarinë e saj.²⁵

²⁴ Leksione, seminare, ushtrime në SS 2001; B. Demiraj: Mitologji shqipe; Konkordanca shqiptarorume në fushën e leksikut; Arbërishtja e Greqisë; Gramatikë praktike e gjuhës shqipe (morphologji); Zhvillimet dhe parimet themelore në Albanologji.; J.Xhyra: Aspekte të semantikës dhe të leksikologjisë shqipe; Shqip III/2; L. Jusufi: Shqip I (tutorium).

²⁵ Leksione, seminare, ushtrime të parashikuara për WS 2001/02: B.Demiraj: E drejta zakonore shqiptare; Fonologji historike e shqipes; Fonologji e gjuhës shqipe; Gramatikë praktike e gjuhës shqipe (sintaksa); Ndikimi sllav në gjuhën shqipe; F.Altimari - B. De-miraj: Dialektet arbëreshe të Italisë. Analizë e teksteve të vjetra të letërsisë arbëreshe; J. Xhyra: Shqip për fillestarë; L. Jusufi (tutore): Shqip II., A. Razgunaite: Fonetikë shqipe (tutorium).